



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 27 Shkurt 2023

Nr: 74

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË BULQIZË, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 27 Shkurti 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Leonard Daci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Bulqizë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Bulqizë, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 18.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Bulqizë.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 27 Shkurt 2023

Nr: 74

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Bulqizë, për raportimin e veprimtarive publike”

1. “Është përkujtuar sot në Sopot të Njësisë Administrative Zergan 80 vjetori i krijimit të Çetës së Grykës së Madhe”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=562072415944780&set=pcb.562073005944721>

*Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”*

2. “Vizitorët e Teqesë së Bllacës do ta kenë më të lehtë vizitën në vendin e shenjtë, falë rrugës që do të nisim të ndërtojmë së shpejti. Lajmin e mirë e ndau Kryetari i Bashkisë Bulqizë z.Lefter Alla me Baba Halil Curri, me të cilin bisedoi jo vetëm mbi nevojat e zonës në tërësi, por edhe ato specifike për besimtarët nga mbarë Bulqiza që e vizitojnë Teqenë gjatë gjithë vitit.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=559982169487138&set=pcb.559982459487109>

*Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 20.2.2023, bashkisë Bulqizë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Me shkresën nr 914 prot. datë 22.2.2023, administruar nga Komisioni Qendrori Zgjedhjeve me nr. 1102 prot. datë 24.2.2023, bashkia Bulqizë informon dhe bën me dije se: “...Organizuesi i të dyjave aktiviteteve të përmenduar në kërkesën tuaj është bashkia Bulqizë. Kryesisht në Sopot Njësia Administrative Zergan u përkujtua 80-vjetori i krijimit të Çetës së Grykës së Madhe pranë Shkollës 9-vjeçare “Jashar Kola” me datë 15.2.2023, ora 14:00, pjesëmarrja nuk ishte madhore dhe nuk kemi pasur prani mediash. Përsa i përket linkut tjetër në Bllacë, ishte një takim me Babain e kësaj teqeje ku diskutuam problemet që lidhen me zonën në tërësi dhe në veçanti atë që kanë besimtarët me rrugën për të shkuar si vizitorë tek teja. Ky takim ishte një takim spontan i zhvilluar të dielën më 11.02.2023 ora 12:00, por në faqet zyrtare të bashkisë Bulqizë është publikuar ditën pas, dhe nuk kishte pjesëmarrje madhore pasi siç e theksuam ishte thjesht një takim spontan me Babain që shërben teqes së Bllacës.”

Data: 27 Shkurt 2023

Nr: 74

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Bulqizë, për raportimin e veprimtarive publike”

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoi se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me evidentimin e karakterit publik të aktivitetit të zhvilluar.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i zhvilluar nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, i tërheq vëmendjen personit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Leonard Daci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Bulqizë.
2. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Bulqizë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 27 Shkurt 2023

Nr: 74  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Bulqizë, për raportimin e veprimtarive publike”